



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:093936

Datë: 31.12.2024

Numri i dokumentit: 06671488

P.nr.250/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Mucaj, në çështjen penale kundër të pandehurit K.N, për shkak të veprës penale “*Kanosje*” nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP.II.nr.353/2024, të datës 21.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.12.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit G.N, të pandehurit K.N, me datën 20.12.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datën 31.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

K.N, i atësisë Z., i amësisë Sh. e vajzërisë, i lindur me datë, në, me vendbanim në rrugën “.....”, në Pejë, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, posedon numër telefoni, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Më parë e gjerë me datën 22.02.2024, rreth orës 12:00, në fshatin, Pejë, me qëllim të frikësimit, në vazhdimësi, seriozisht e kanosë me fjalë të dëmtuarin G.N, në atë mënyrë që, i pandehuri në vazhdimësi i dërgon të dëmtuarit mesazhe me përmbajtje “kom plumba sa dush del a je njeri, ti e paske pas veç me marr fakte po dil, apo del te furra Dielli i japum fund ksaj jete”, ku i pandehuri me datën e lartcekur shkon tek shtëpia e të dëmtuarit dhe djalit të tij të mitur i drejtohet me fjalët “ku e ke babën, hajt se unë e gjoj, për të Pejës nuk ka ku shkon”, të cilat fjalë tek i dëmtuari kanë shkaktuar ankth dhe panik,

- Me çka ka kryer veprë penale “*Kanosja*” nga neni 181 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në bazë të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 77 nenit 181 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449, 452, 462 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej një mijë (1000) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në afatin e caktuar, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro, për një (1) ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- IV.** I dëmtuari G.N, me adresë në fshatin,, Komuna e Pejës, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datën 21.03.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP.II.nr.353/2024, kundër të pandehurit K.N, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Kanosje*” nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata me datën 17.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari G.N, si dhe i pandehuri K.N.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta, dëshiron të mbrohet personalisht dhe se është i gatshëm të vazhdohet me seancën.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata, e ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit apo mospranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar këto të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast dhe i pandehuri K.N, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihet në barrë dhe i kërkon falje të dëmtuarit, respektivisht për veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Ngjashëm ka deklaruar edhe i dëmtuari G.N: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i Policit F.I. #0250, i dt. 22.02.2024, Raporti i Policit M. M. #0413, i dt. 22.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin G.N, i dt. 22.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin B.N., i dt. 22.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin K.N, i dt.22.02.2024, 4 (katër) foto.* Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, në fjalën e tij përfundimtare duke u deklaruar për rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që në kuptim të rrethanave rënduese të marr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurit si dhe faktin që vepra penale është kryer në kuadër të marrëdhënies familjare ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimit e fajësisë.*

I dëmtuari G.N, ka deklaruar se: *K. edhe pas këtij rasti edhe dy herë të tjera më ka kërcënuar, i njëjti nuk më ka kërkuar falje për veprimet e tij, unë ia kam falur disa herë por i njëjti vazhdon të i përsërit veprimet, nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, vetëm dëshiroj që i njëjti të më lejë rahat.*

I pandehuri K.N, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i kam kërkuar falje të dëmtuarit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të “Kanosje” nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv i këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, faktin që palës së dëmtuar i ka kërkuar falje gjatë seancës fillestare, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer, si dhe faktin se i njëjti nuk është i dënuar më parë bazuar në certifikatën mbi dënimet penale (të datës 26.12.2024), ndërkaq si rrethana rënduese në rastin konkret gjykata mori shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre penale e cila rezulton të jetë kryer në vazhdimësi si dhe faktin se vepra penale është kryer në kuadër të marrëdhënies familjare.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, mbi këto arsye, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 43 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 458, 459 dhe 460 të KPRK-së, pasi që i dëmtuari G.N, me adresë në fshatin,, komuna e Pejës, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kërkesë-pasurore juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.250/24, me datën 31.12.2024.

Bashkëpunëtorë profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajqi-Mucaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.